



SHQIPTARËT DHE MODELI SOCIAL EVROPIAN

Mangesitë, pengesat, sfidat, vizionet

Piro Misha



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

Piro Misha

**SHQIPTARËT DHE MODELI
SOCIAL EVROPIAN
Mangesitë, pengesat, sfidat, vizionet**



Tiranë, 2015

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-të
Kutia Postare 1418
Tiranë, ALBANIA

Autor: Piro Misha

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosodshmërisht ato të Fondacionit Friedrich-Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Pasqyra e lëndës

1. Hyrje: Përse ky raport?	5
2. Çfarë do të thotë 'Modeli Social Evropian'?	9
3. Rruga e vështirë drejt një modeli	11
4. Pritshmëritë e qytetarit.....	19
5. Demokracia jo-funksionale dhe qytetari	33
6. Fragmentizimi i shoqërisë dhe mungesa e kohezionit social	41
7. A ekziston një kërkesë për një shoqëri më të drejtë dhe më solidare nga ana e shqiptarëve?.....	48
8. Procesi i integritit në Bashkimin Evropian dhe roli i tij në shndërrimet e ndodhura në shoqërinë shqiptare	55
Shënime.....	57

1. Hyrje: Përse ky raport?

Në vitin 1991 regjimi komunist u rrëzua në Shqipëri nën thirrjet e studenteve të universitetit të Tiranës, “E duam Shqipërinë si gjithë Europa!”. Që prej asaj kohe antarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka qenë dhe vazhdon të jetë aspirata kryesore e pjesës më të madhe të shqiptarëve. Në fakt, nga të gjitha sondazhet rezulton se shqiptarët janë një ndër popujt më entuziastë përse i takon perspektivës së integritimit evropian. Përqindja e atyre që janë në favor të integritimit i kalon të 90 për qindët. Po ashtu, pothuajse të gjitha forcat politike në Shqipëri e kanë objektivin e integritimit evropian në krye të programeve të tyre politike, duke e konsideruar atë si objektivin strategjik madhor të vendit.

E megjithatë, pasi thamë të gjitha këto, është legjitime të shtrohet pyetja:

Përtej retorikës për integritimin evropian, a janë vërtet shqiptarët të vetëdijshëm se ç’nënkupton në realitet integritimi evropian në terma ekonomike, sociale, politike e kulturore?

A janë ata tërësisht të vetëdijshëm për faktin se procesi i integritimit evropian nënkupton para së gjithash, nevojën një sërë ndryshimesh të thella e të gjithanshme në vetë realitetin shqiptar? Madje dhe në koncepte e shprehje që shpesh mund të kenë rrënjë të ngulitura thellë në të kaluarën, sidomos për sa i takon raporteve të qytetarit me shtetin dhe me ligjin, raportit mes të drejtave dhe detyrimeve që

ai ka, e kështu me radhë.

A janë shqiptarët mjaftueshëm të informuar se cilat janë ato parime e vlera kryesore që qëndrojnë në themel të filozofisë mbi të cilën është ngritur Bashkimi Evropian, të cilat bënë të mundur që për më se gjysmë shekulli të arrihet të sigurohet paqia, zhvillimi, mirëqenia e progresi ekonomik, por po ashtu edhe ai shoqëror?

A kanë qenë gjithnjë ndryshimet e shumta që kanë ndodhur në shoqërinë shqiptare gjatë dy dekadave të fundit në drejtimin e duhur, duke i shërbyer 'evropianizimit' të saj ?

Cilat janë pengesat kryesore në rrugën tonë drejt adaptimit të një modeli social evropian? A janë sfidat kryesore me të cilat përballemi me karakter politik, ekonomik, institucional, social apo kulturor?

Dhe së fundi, cili është roli që ka luajtur gjatë kësaj periudhe klasa politike? Po aktorët e tjerë me peshë në shoqërinë shqiptare?

Në 24 qershor të vitit 2014, më në fund, pas një pritjeje prej pesë vjetësh që nga çasti kur kish paraqitur kërkesën, më në fund Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat për në Bashkimin Evropian. Ende nuk është vendosur një datë se kur do të hapen negociatat për antarësim, por sidoqoftë, mund të thuhet se tashmë, pavarësisht pengesave e vështirësive jo të pakta, perspektiva e antarësimit në Bashkimin Evropian duket më e qartë se kurrë ndonjëherë më parë.

Është pra, pikërisht çasti që shoqëria shqiptare t'u japë një përgjigje këtyre pyetjeve e të bëjë një bilanc të asaj që është arritur, të asaj që ka nevoja të korrigjohet, e sidomos të reformave që

duhen ndërmarrë për të kryer ato ndryshime që nevojiten për të përmbushur ato standarte që kërkon antarësimi ynë në BE.

Pikerisht këtyre pyetjeve, si dhe shumë të tjerave, është përpjekur t'u japë një përgjigje projekti i iniciuar nga Fondacioni Friedrich Ebert, së bashku me ekspertët dhe drejtues të gjashtë organizatave dhe Think-Tank-ve vendas. Produkti janë tre studime, të bazuar në tre sondazhe për tre tematika të ndryshme, por që së bashku kontribuojnë për të krijuar një ide mjaft më të saktë të problematikës me të cilat përballet shoqëria shqiptare sot, e rjedhimisht të sfidave që ajo ka përpara në rrugën drejt antarësimit në Bashkimin Evropian. Studimi i parë, i kryer nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, me autore Sashenka Lleshaj dhe Alba Çelën, ka për temë 'Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale.' I dyti, i realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me autore Elona Dhembo, ka për temë, 'Adiministrata Publike në Shqipëri midis Politikës dhe Qytetarit.' I treti, me autor Afrim Krasniqin dhe Ardian Hackaj, ka për temë 'Demokracia e Brendshme në Partitë Politike Shqiptare'. Të tre sondazhet janë kryer gjatë vitit 2014. Të tre studimet kanë për bazë bindjen se integrim do të thotë, para së gjithash, modernizim, zhvillim, demokratizim dhe europianizim i jetës së vendit. Dhe ç'është më kryesorja, të tre kanë një objektiv të përbashkët, që i bënë ata të jenë pjesë e të njëjtit projekt, përqasja e realitetit shqiptar, përfshirë disa nga aktorët e faktorët më të rëndësishëm që veprojnë në të, me ato standarte që vendi duhet të përmbushë për të plotësuar atë që tashmë njihet si 'Modeli Social European'.

Ky studim i katërt, pjesë e të njëjtit projekt, ka për synim të bëjë në

një farë mënyre një përmbledhje të gjetjeve të tre studimeve të lart përmendura dhe, duke u mbështetur dhe në një sërë studimesh dhe hulumtimesh të kryera nga organizata të tjera, të sjellë një tablo më të gjerë të momentit që po kalon tranzicioni shqiptar, gjithnjë duke e krahasuar me parametrat e Modelit Social European, që fundja, kanë për të qenë standartet me të cilët do matet Shqipëria për t'u gjykuar nëse do të jetë e gatshme apo jo për t'u bërë antare me të drejta të plota e Bashkimit Evropian.

Në cdo vend demokratik politika e ka të domosdoshme të dijë se ç'mendojnë e ç'presin prej saj qytetarët: sondazhet janë baza mbi të cilën hartohen programet, ngrihen politikat, përcaktohen prioritetet dhe objektivat. Ndaj dhe anketimet që sjellin tre studimet e përmbledhura në këtë projekt, s'janë thjeshtë një gjykim i performancës së një qeverisje të caktuar, apo dhë të klasës politike shqiptare gjatë një periudhe të caktuar. Ato përbëjnë një instrument tepër të çmuar për të kuptuar disa prej aspekteve më të rëndësishme të tranzicionit shqiptar, të kahjeve, kontradiktave, por para së gjithash sfidave që na presin për ta çuar deri në fund atë rrugë që nisëm të nesërmen e rënies së komunizimit. Pikërisht ky është dhe qëllimi i këtij raporti të katërt, që përndryshe mund të quhet dhe 'A Merger Report': duke analizuar gjetjet e të tre raporteve pjesë e projektit, të sjellë vemendjen të sfidat që na presin për të përmbushur objektivin strategjik të shqiptarëve: antarësimin në Bashkimin Evropian.

2. Çfarë do të thotë ‘Modeli Social Evropian’?

Bashkimi Evropian nuk është thjeshtë një bashkim ekonomik e politik, por është para së gjithash një bashkim vlerash: ky është parimi bazë mbi të cilin mori formë ideja e një tregu të përbashkët mes vendeve europiane, duke i dhënë jetë në vitin e largët 1951 Komunitetit Ekonomik Evropian, të përbërë aso kohe nga vetëm gjashtë vende: Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Sot Bashkimi Evropian përbëhet nga 28 vende, por vizioni mbi të cilin ai ngrihet është gjithnjë ai i fillimeve: Vizioni i përbashkët i etërve themelues për një Evropë të Bashkuar, të cilët gjykuan se e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund konflikteve dhe për të siguruar një paqe të qëndrueshme në kontinentin që sapo kishte dalë nga një luftë e përgjakshme, që të krijohet një sistem vendimarrjeje dhe bashkëpunimi i përbashkët, i cili do të mund të siguronte zhvillim e përparim ekonomik e social, të ngritur mbi parimin e solidaritetit dhe të kohezionit social. Në fakt, pavarësisht ndryshimeve që mund të ekzistojnë mes vendeve apo rajoneve të ndryshme nga të cilat përbëhet sot Bashkimi Evropian, ajo që i dallon ato është objektivi për një organizim social që të garantojë një shoqëri sa më të drejtë, që t'iu sigurojë qytetareve respektimin e të drejtave të tyre themelore, mbrojtjen sociale, si dhe që të sigurojë dialogun social, si faktorin rregullues të ekuilibrave sociale në shoqëri.

E gjithë kjo njihet me termin ‘Modeli Social Evropian’, në themel të të cilit qëndron parimi se zhvillimi ekonomik s’duhet të shërbejë vetëm

për të pasuruar një grusht të vogël njerëzish, siç kishte ndodhur më së shumti në të kaluarën, por ai duhet të shërbente për siguruar një mirëqenie të përgjithshme të shoqërisë, duke shmangur dallimet e tepruara sociale dhe ekonomike, për të mos lejuar që zhvillimi dhe pasurimi të kryet në kurriz të ndonjë prej segmenteve më të dobët të shoqërisë.

Pra, e thënë shkurt, ‘Modeli Social Evropian’ është një strukturë politike dhe social-ekonomike, e përbashkët për thuajse gjithë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, e cila ka si tipar të saj kryesor të ashtuquajturin Welfare State (shtet të mirëqënies), ose e thënë ndryshe, detyrimin e shtetit për t’i garantuar të gjithë qytetarëve mirëqënien, mbrojtjen sociale e respektimin e të drejtave që iu jep ligji.

Dokumentet bazë që e sanksionojnë këtë me ligj janë: The Treaty of the European Community; The EU Charter of Fundamental Rights (3) etj.

Në një kuptimi, mund të thuhet se ‘Modeli Social Evropian’ përbën vetë thelbin e vizionit mbi të cilin është ngritur Bashkimi Evropian, atë vizion me të cilin çdo vend e popull që aspirojnë të bëhet pjesë e tij do duhet vazhdimisht të krahasohet për të gjykuar e kuptuar nëse vërtet është në rrugën e duhur që po e çon drejt integritit në Bashkimin Evropian.

3. Rruga e vështirë drejt një modeli

Gjatë fazës së tij të parë, projekti 'Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian', i iniciuar nga Friedrich Ebert Stiftung, dhe i realizuar së bashku me gjashtë organizata dhe Think Tank-e vendase, kishte për qëllim të sillte këndshikimin e problematikën e disa prej aktorëve kryesorë të shoqërisë shqiptare, që në një mënyrë a një tjetër kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në ritmet e rrugëtimit të vendit drejt objektivit të integritimit në Bashkimin Evropian. Të tre studimet pjesë e këtij projekti, nëpërmjet analizave, sondazheve dhe rekomandimeve të bëra, ofrojnë padyshim një bazë të mirë të dhënash, e cila mund të përdoret për të kuptuar më mirë problematikën e sfidat e vështira me të cilat Shqipërisë është duke u përballur vendi e, c'është edhe më e rëndësishme, do t'i duhet përballet gjatë viteve të ardhshme.

Por sidoqoftë, gjetjet e këtyre tre studimeve s'janë veçse 'fotografime të castit', pra ato sjellin atë që përfaqësuesit e disa prej aktorëve me peshë të shoqërisë mendojnë sot. Që këto gjetje të mund të lexohen, vlerësohen e analizohen sic duhet, ato duhen vendosur në kontekstin e duhur kohor, duke i parë të lidhura me gjithë historikun e tranzicionit pas-komunist shqiptar. Vetëm kështu do mund të kuptohen arsyet, shkaqet e faktorët historikë, ekonomikë, politikë, socialë e kulturorë që i kanë sjellë në jetë, i kanë ushqyer apo dhe vazhdojnë të mbajnë gjallë shumë prej dukurive apo mendësive e sjelljeve që na shqetësojnë.

Kjo është arsyeja e këtij përvijimi fare të shkurtër të rrugëtimit të tranzicionit të gjatë pas-komunist shqiptar, duke e venë theksin tek ato çështje që gjykojmë, janë është ende relevante dhe vazhdojnë të ndikojë në dukuritë, kundërshtitë, tensionet, mendësitë, arritjet e dështimet e të ashtuquajturit tranzicion shqiptar.

Në vitet 1990-91, kur sundimi komunist u shemb në Shqipëri pas thujtse gjysëm shekulli, Evropa ishte kryefjala e çdo ligjërimi në gojën e liderve të rinj politik. Shumë shpejt të gjitha forcat e reja që u shfaqën në skenën politike, madje dhe ish-komunistët, shpallën si objektivin e tyre strategjik integrimin në atë që aso kohe njihej me termin ‘Aleanca Euro-Atlantike’, ku krahas Europës së Bashkuar përfshihej dhe NATO. Në fakt, pjesa më e madhe e shqiptarëve që sapo kishin dalë nga komunizmi, mendonin se me të rënë regjimi, ‘Europa’ do të qe fare pranë, e se rruga e tyre drejt një shoqërie të zhvilluar e moderne të tipit perëndimor kish për të qenë diçka relativisht e lehtë.

Por, në fakt, sic dihet, rezultoi e kundërta. Për shqiptarët tranzicioni pas-komunist rezultoi mjaft më i vështirë dhe i gjatë se për thujtse çdo vend tjetër ish komunist të Evropës Lindor e Qendrore. Arsyet e kësaj janë të shumta dhe s’është vendi të analizohen këtu në mënyrë të hollësishme.

Siç dihet, për shqiptarët tranzicioni pas-komunist rezultoi mjaft më i vështirë dhe i gjatë se për thujtse çdo vend tjetër ish komunist të Europës Lindor e Qendrore. Arsyet e kësaj janë të shumta dhe s’është vendi të analizohen këtu në mënyrë të hollësishme. (4)

Ajo që mund të thuhet këtu, është se në vitet '90 shqiptarët dolën nga komunizmi dhe hynë në rrugën e ndryshimeve, duke u përballur me gjithë pasojat dramatike të së shkuarës së tyre. Komunizmi autarkik shqiptar kishte lenë pas një katastrofë të vërtetë ekonomike. Shqipërisë së viteve 1990 i mungonin shumë nga ato parakushte që duhet të plotësojë një vend e një popull që të jetë i aftë të adaptojë modelin perëndimor të modernitetit. I mungonte, para së gjithash, ai minimum zhvillimi ekonomik modern që nevojitet për të ngritur një sistem demokratik liberal të mbështetur në një ekonomi të lirë të tregut. Shqipëria e fillimit të viteve '90 ishte jo vetëm vendi më i prapambetur i Evropës, por dhe një vend ku mungonte një klasë e mesme e konsoliduar qytetare, e cila siç dihet, përbën kolonën mbi të cilën mbështetet stabiliteti shoqëror i një vendi. Mungonte një traditë e vërtetë dhe e qenësishme borgjeze e qytetare. Mungonin institucionet e pavarura, të cilat do të mund të siguronin atë nivel të nevojshëm stabiliteti shoqëror për një kalim deri diku të butë nga një sistem politik tek tjetri. Mungonte, po ashtu, një elitë e aftë për të drejtuar një vend kaq të varfër e të prapambetur në rrugën e modernizimit drejt një demokracie liberale. Në fakt, siç dihet, elita politike e intelektuale që pas vitit 1991 mori në duar drejtimin e vendit, ishte e dalë thuajse tërësisht nga elita e kohës së komunizmit, çka do të thotë se në përgjithësi, mënyra e saj e sjelljes dhe e të menduarit mbetej kryesisht e kushtëzuar prej së shkuarës, duke pasqyruar drejtpërsëdrejti përvojën e tyre të mëparshme. **Mungonte, ç'është kryesorja, çfarëdo përvoja demokratike.**

S'duhet harruar po ashtu, se në vitin 1990 Shqipëria qe një vend kryesisht rural, me përqindjen më të lartë (në fakt, mjaft më të lartë)

të popullsisë fshatare në Europë (zyrtarisht, popullësia që jetonte në fshat në vitin 1990, llogaritej 70%). Një fakt, ky që e dallonte atë dukshëm nga gjithë vendet e tjera ish-komuniste europiane. Në të vërtetë, ky fakt shpjegon dhe përse në Shqipëri ndryshimi i sistemit s'që thjeshtë një shndërrim i natyrës politike e ekonomike nga diktatura në kapitalizëm e demokraci, nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur, nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut, siç ndodhi në shumicën e vendeve të tjera ish-komuniste të Evropës.

Ishte pikërisht kjo përbërje e popullsisë arsyeja përse, me t'u larguar trysnia e diktaturës, u vunë sakaq rrëmujsëm në lëvizje një sërë procesesh të tjerë transformues me natyrë shoqërore, kulturore, psikologjike dhe sigurisht demografike, të cilët sollën probleme, tendosje, dilema e mëdyshje të një natyre e madje patologjike krejt të veçantë, duke krijuar atë gjendje të përgjithshme anarkie sociale që përbën një ndër tiparet më domethënës e më dramatik të tranzicionit paskomunist shqiptar.

Ndërkohë, kjo paraqitje fare e shkurtër e disa prej faktorëve të trashëguar që në një masë a një tjetër, kontribuan për të plazmuar tranzicionin paskomunist shqiptar, do të ishte krejt e mangët, po të mos përfshinim në të faktorin izolim, që përbën tiparin ndoshta më dramatik të komunizmit autarkik shqiptar. Sigurisht, efekti më dramatik i hapjes sonë së menjëhershme ndaj botës ishte ndërgjegjësimi sesa të varfër e të prapambetur ishim krahasuar me të tjerët. Befas shqiptarët kuptuam se sa i thellë ishte hendeku që i ndante nga popujt e tjerë, qoftë edhe nga fqinjët e rajonit. Pra, dihej se rasti shqiptar, ndonëse në disa aspekte i ngjashëm me vendet

e tjera paskomuniste, përbënte, gjithsesi, një rast unikal, ndaj dhe kalimi nga komunizmi autarkik enverist në një sistem tjetër do të ishte më i vështirë. S'duhet harruar se vendi s'kishte njohur kurrë në të kaluarën e tij një traditë demokratike e të pluralizmit ku do të mund të mbështetej. (5)

Të gjitha këto janë të vërteta, por po ashtu, s'ka asnjë dyshim se një përgjegjësi të madhe për kaosin ekonomik, shoqëror dhe kulturor që shoqëroi vendosjen e pluralizmit në Shqipëri, ku shpesh paaftësia e shtetit për të kontrolluar proceset u përligj me pseudo-teori liberaliste e neoliberaliste, të cilat në praktikë sollën një situatë vështirë të dallueshme nga anarkia, e kanë ata që e kanë drejtuar vendin gjatë kësaj periudhe. Mëkati më i rëndë i klasës politike që qeverisi vendin gjatë këtyre 25 vjetëve është deformimi që ata i bënë modelit politiko-ekonomik e social që shqiptarët aspironim të adaptonim, një deformim ku, në të vërtetë, e kanë zanafillën shumë nga problemet me të cilat ndeshet vendi sot.

“Neoliberalistët shqiptarë menduan se rimëkëmbja do të mund të vinte nëpërmjet shkatërrimit” - këto janë fjalët e dy studiuesve amerikanë të Universitetit të Yale-it të cilët në një libër që i kushtonin tranzicionit paskomunist në Europën Lindore, janë mjaft kritikë përse i takon një pjese të madhe të politikave pseudo-liberaliste që u zbatuan në Shqipëri gjatë viteve '90. Sidomos të ashpër ata janë përse i takon të ashtuquajturës strategji të terapisë së shokut, që u zbatua në vend gjatë viteve 1990. (6)

Ky lloj kapitalizmi solli vërtet një çlirim të madh energjish individuale, por, nga ana tjetër, solli një prishje të përmasave të mëdha të

moralit publik, një parazitizëm masiv, solli mendësinë se mund të pasuroheshe pa shumë mund, qoftë edhe me forma e rrugë të paligjshme; solli, në fakt, nxitjen në emër të demokracisë dhe antikomunizmit të disa prej veseve më të këqija të trashëguara.

Në shoqërinë e brishtë shqiptare, të tronditur nga ndryshimet tepër të shpejta e rrënjësore, relativizimi i vet konceptit të ligjit, shartimi kaotik i ideve e praktikave, solli anarkinë dhe një krizë të rëndë morale, një prishje të gjithë sistemit të vlerave. Pjellë e këtij deformimi ishin dhe piramidat financiare dhe drama që ato sollën në mes të viteve 1990. Rezultati është kriminalizimi i segmenteve të rëndësishëm të shoqërisë dhe bashkëjetesa e politikës me krimin. Rezultat është simbioza e një pjese të madhe të administratës qendrore e lokale me një shtresë të sapokrijuar pasanikësh të rinj arrogantë, e pa shumë skrupuj. Përfundimi që shkërmoqja graduale e autoritetit të shtetit dhe, më pas, e vetë ngrehinës së tij dhe humbja e shpresës për shqiptarin e thjeshtë e të çoroditur se gjërat një ditë mund të ndreqen. Pasoja më e dukshme e dramatike fakti që mbi 30% e shqiptarëve duke pasur më besim se gjërat mund të ndryshonin zgjodhën rrugën e emigracionit, duke u larguar nga vendi e shpërndarë nëpër botë.

Polarizmi politik ekstrem, dobësia e institucioneve të pavarura, në mënyrë të veçante e sistemit të drejtësisë, paaftësia për arritjen e kompromisit, polarizimi ekstrem ekonomik e social, korrupsioni, margjinalizimi gjithnjë e më i dukshëm i grupeve e zonave të caktuara, u kthyen shpejt në pengesa serioze për një zhvillim normal të vendit. S'ka dyshim se të gjitha këto përbëjnë sot sfida madhore që duhen përballuar.

Por megjithatë, 25 vjet pas ndryshimit të sistemit, pavarësisht nga vështirësitë, deformimet, devijimet apo dhe kthimet mbrapa, duke marrë parasysh pikënisjen Shqipëria mund të konsiderohet si ndoshta vendi që ka pësuar transformimin më të thellë e më të plotë ndër gjithë vendet e tjera ish-komuniste. Rëndësi ka se, pavarësisht problemeve dhe sfidave të mëdha që mbeten për t'u zgjidhur, shqiptarët tashmë e kanë përqafuar demokracinë si formën më të dëshirueshme të qeverisjes dhe si qëllimin kryesor të tranzicionit politik të vendit. Asnjëherë partitë politike, apo aktorë të tjerë me peshë në vend, s'kanë kontestuar legjitimitetin e institucioneve demokratike në vend. Krijimi i një parlamenti shumëpartiak me zgjedhje të lira, vendosja e themeleve të ekonomisë së tregut, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO (7) dhe sidomos marrja një vit më parë e statusit të vendit kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (8), janë po ashtu padiskutueshëm arritje të mëdha të tranzicionit shqiptar. Pra, mund të thuhet se, pavarësisht se deri më sot, ende s'ka një datë të saktë se kur do të nisin negociatat për asocim me Bashkimin Evropian, vendi është më afër se kurrë realizimit të aspiratës së tij madhore.

Por po ashtu, është pikërisht ky çasti për t'u ndërgjegjësuar se cilat janë ato kushte që vendi do duhet të përmbushë në mënyrë që një ditë jo shumë larg të arrijë të pranohet antar me të drejta të plota i Bashkimit Evropian. Shqiptarët, populli ndoshta më entuziast në Ballkan përsa i takon integritet në Bashkimin Evropian, tashmë është koha të informohen dhe vetëdijësohet se cilat janë sfidat me të cilat do t'u duhet të përballen në mënyrë që të përmbushin standardet që kërkohen prej tyre. E në këtë kontekst, të kuptojnë se cilat janë standardet evropiane të të ashtuquajturit Model Social

Evropian, si një ndër komponentët kryesorë të realitetit evropian, që shoqërisë shqiptare do t'i duhet të plotësojë.

Rëndësi ka, sidoqoftë, të theksohet, sic e tregojnë dhe gjetjet e këtyre tre studimeve e anketimeve, se tashmë janë gjithnjë e më të shumtë ata që janë duke e kuptuar se ëndrra e kahershme për tu bërë pjesë e 'Evropës', do të bëhet vërtet realitet vetëm atëherë kur vetë shoqëria shqiptare do të jetë 'europianizuar', pra vetëm pasi të ketë ndryshuar shumëçka që deri më sot s'ka funksionuar, apo ka funksionuar keq. Gjë që kërkon para së gjithash bashkë përfshirjen, bashkëpunimin e mobilizimin e gjithë aktorëve me peshë në këtë shoqëri që ndajnë ëndrrën për një Shqipëri anëtare të Bashkimit Evropian

4. Pritshmëritë e qytetarit

Të tre studimet/sondazhet, pjesë e projektit 'Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian', i japin një përgjigje një sërë pyetjesh të rëndësishme që lidhen me një nga komponentët më të rëndësishëm të një sistemi demokrat: pritshmëritë e qytetarit nga procesi i integritimit, apo më në përgjithësi, në raport me shtetin dhe institucionet e tij. Por njëkohësisht, nëpërmjet gjetjeve të këtyre tre studimeve, ke mundësinë të arrish të krijosh një ide dhe se cilat janë nocionet në bazë të të cilave ngrihen këto pritshmëri apo dhe perceptime.

Por para së gjithash, gjetjet e të tre studimeve të lejojnë t'i japësh një përgjigje një sërë pyetjesh të tjera me po aq rëndësi në lidhje me procesin e integritimit të vendit në Bashkimin Evropian:

- A përkon pritshmëria e qytetarëve shqiptarë me ato ndryshime që duhet të ndodhin në gjirin e shoqërisë shqiptare në mënyrë që ajo të mund të pranohet si anëtare me të drejta të plota e Bashkimit Evropian?
- A janë shqiptarët mjaftueshëm të informuar se cilat janë standardet që Shqipëria duhet të përmbushë në këtë proces?
- Kur themi që mbi 90% e shqiptarëve (pra, më shumë se çdo popull tjetër që troket në dyert e Evropës) janë në favor të integritimit në Bashkimin Evropian, a duhet lexuar kjo si një tregues se pjesa më e madhe e shqiptarëve vërtet ndan të njëjtin vizion e të njëjtat vlera përsa i takon organizimit

të shoqërisë me ato mbi të cilat është ngritur ky bashkim politik-ekonomik krejt unikal në llojin e vet?

- Dhe së fundi, a e kuptojnë ata se ç'nënkuptohet me konceptet 'model social evropian', shtet social, shtet i mirëqënies (welfare state), etj?

Ndërsa dhe më parë ka pasur një sërë studimesh e anketimesh kryesisht me karakter politik apo dhe ekonomik, me autorë vendas apo të huaj, duhet thënë se studimet dhe anketimet që kanë në qendër të tyre problematikën që lidhet me zhvillimet sociale të shoqërisë shqiptare, kanë qenë fare të pakta, ose kanë qenë ngushtësisht sektoriale. Ndaj dhe mund të thuhet ky projekt ka një vlerë të shumëfishtë. Në mënyrë të veçantë me vlerë për këtë kapitull, por dhe për disa prej kapitujve poasardhës, është studimi/sondazhi 'Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale', me autor Sashenka Lleshaj dhe Alba Çela, i cili ka si target qëndrimet e qytetarëve në përgjithësi.

Sidoqoftë, në përgjithësi, mund të thuhet se vlera e informacionit që sjell ky projekt është e shumëfishtë:

Së pari, projekti bën një fotografim që sjell një vështrim shumëdimensional të shoqërisë shqiptare gjatë vitit 2014, pra në periudhën menjëherë pas zgjedhjeve politike që u zhvilluan në qershor të vitit 2013. Me mjaft interes janë në këtë shikim dhe gjetjet e studimit/sondazhit që ka në qendër demokracinë e brendshme në partitë politike shqiptare, pikërisht në një kohë kur ka mjaft diskutime për vetë modelin në bazë të të cilit ngritur partitë shqiptare dhe rolin që ato luajnë.(9)

Së dyti, gjetjet e këtyre tre studimeve shërbejnë si një lloj barometri për të kuptuar qëndrimin e qytetarëve për performancën e qeverisjes, si dhe të shtetit, e më në përgjithësi, të institucioneve të tij. Por po ashtu, një barometër që mat qëndrimin qytetar për disa çështje mjaft të diskutuara vitet e fundit që lidhen një sërë problemesh me rëndësi strategjike për zhvillimin e ardhshëm të vendit, siç është diskutimi për privatizimet në mjaft prej sektorëve më të rëndësishëm të shërbimeve, për raportin publik/privat, për formën e qëllimit të taksimit (taksë e sheshtë apo progresive?), etj. Pra, e thënë shkurt, na jepet një ide se cili është në këndshikimin e qytetarit, modeli i zhvillimit që duhet ndjekur. Në këtë shikim, gjetjet e këtyre tre studimeve, e në mënyrë të vecantë ato të studimeve/sondazh, do duhet të lexohen me mjaft vemendje nga politikanët shqiptarë.

Së treti, duke sjell vizionin qytetar për zhvillimin e ardhshëm të vendit, në një farë mënyre projekti na sjell një tablo të nivelit të përgjithshëm të kulturës politike në shoqërinë shqiptare, element ky me rëndësi për të të gjykuar nivelin e demokracisë shqiptare dhe, njëkohësisht, sfidat që lidhen me mendësitë e shprehite të trashëguara, me të cilat përballemi në rrugën e emancipimit shoqëror.

Cilat janë disa prej përfundimet kryesore që mund të nxirren nga gjetjet e të tre studimeve/sondazheve, pjesë e projektit ‘Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian’?

Së pari, se cilat janë, në këndshikimin qytetar, shqetësimet më të mëdha me të cilat përballlet sot vendi. Sipas gjetjeve të sondazhit

të kryer nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, rezultati në fakt, s'përbën ndonjë surprizë. Pjesa më e madhe të të pyeturve (87 përqind e tyre), mendon se problemi më madhor që ka vendi sot është papunësia; e ndjekur kjo nga varfëria (me 75 përqind e të pyeturve.). Kurse rreth gjysma e të intervistuarve sheh si problemin më të madh të vendit, drejtësinë (53 përqind), kurse pas saj, shqetësim janë standardet e ulëta të kujdesit shëndetësor, e kështu me radhë. (10)

Sipas autorëve të studimit, panorama që jepte sondazhi i vitit 2014, thuajse nuk ndryshon nga ajo e një viti më parë, pra e vitit 2013. Kjo të bën të mendosh se bëhet fjalë për probleme që në këndshikimin e qytetarit s'janë të reja, por që njëkohësisht vazhdojnë të beten po njëjloj shqetësuese, duke mos gjetur zgjidhje.

Përfundimi i dytë që të bie menjëherë në sy duke lexuar gjetjet e këtyre tre studimeve, është ai që lidhet me situatën e demokracisë në vend. Në fakt, në këtë s'është se ky projekt sjell ndonjë risi, ai veç konfirmon një të dhenë që e kanë konstatuar një sërë studimesh të tjera me pak a shumë të njëjtën temë: faktin që pjesa më e madhe e shqiptarëve kanë mendimin (perceptimin) se jetojnë në një demokraci të pjesshme, pra në atë që në literaturën politike për tranzicionin pas-komunist, njihet me termin 'regjim hibrid', ose në një demokraci të pjesshme. Sipas raportit të AIIIS, 72 përqind e të anketuarve mendojnë se jetojnë në një demokraci të pjesshme. (11)

Në lidhje me këtë konkluzion dhe, sidomos me faktin që përqindja atyre që s'kalonin në të dy ekstremet, duke e quajtur vendin ose

plotësisht demokreatik, ose aspak demokratik, por pozicionoheshin në qendër, duke e konsideruar atë si 'një vend jo plotësisht demokratik', ka pasur një rritje relative krahasuar me anketimin e kryer gjatë vitit 2013, hartuesit e studimit të shtrojnë pyetjen se mos ndoshta ky fakt duhet lexuar si një zhvillim pozitiv. (12) Është ky është një diskutim interesant, i cili shtjellohet në mënyrë më të detajuar në kapitullin në vijim, ndaj dhe s'e shohim të udhës të zgjatmi më gjatë këtu .

Por, për mendimin tim, përfundimi më interesant që mund të nxirret nga gjetjet e të tri studimeve, (që në fakt mbështet dhe nga një sërë studimesh të tjera), është fakti se, edhe gati një çerek shekulli pas rënies së komunizmit, duket se disa fenomene që dikur shiheshin si dukuri kalimtare të lidhura me tranzicionin, tashmë mund të thuhet se janë kthyer në tipare permanente të shoqërisë shqiptare, që përbëjnë pengesa serioze për zhvillimin e vendit, e sidomos në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

I tillë është padyshim **problemi i mosbesimit të përhapur ndaj institucioneve të shtetit**, e më në përgjithësi, ai lloj ambiguiteti që ekziston në raportet qytetar-shtet, që tashmë prej njëzet e pesë vjetësh përbën një nga dukuritë më shqetësuese të shoqërisë shqiptare, e njëkohësisht padyshim, një pengesë në procesin e europianizimit të vendit.

Sondazhi i kryer si pjesë e studimit të ISHSN, 'Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale' na jep të dhëna interesante në këtë drejtim. Kështu, sipas tij, rezulton se vetëm 49 përqind e shqiptarëve kanë

besim tek qeveria shqiptare, kurse niveli i atyre që kanë besim tek Parlamenti është edhe më i ulët, vetëm 39%; tek partitë politike rezulton të kenë besim vetëm 15% e shqiptarëve. (13)

Situata bëhet vërtet shqetësuese sidomos kur sheh nivelin e lartë të mosbesimit të qytetarëve për institucione të tillajetike për funksionimin normal të një shoqërie e aq më shumë të një demokracie, si gjykatat e sistemi i drejtësisë në përgjithësi, apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Tipare permanente të tranzicionit shqiptar duket sikur janë bërë dhe një sërë deformimesh të tjera, si p.sh. korrupsioni apo dhe partitokracia.(14)

Sidoqoftë, në këtë pikë, nga të gjitha këto të vjen natyrshëm një pyetje: a është me vend që në castin në të cilin po kalon sot shoqëria shqiptare, të flitet por një krye-sfidë, pra për një problem mbi problemet, nga zgjidhja e të cilit varet dhe bllokimi i një sërë nyjesh të tjera që mbajnë të lidhur tranzicionin shqiptar?

Përgjigja duket se është po. Sepse, qoftë edhe duke lexuar këto tre studime, s'është e vështirë të arrish në konkluzionin se sfida kryesore dhe ndoshta dhe më e vështira, me të cilën përballlet sot shoqëria dhe demokracia shqiptare është ajo e ndërtimit të një shteti ligjor, si dhe të krijimit të raporteve të mirëbesimit mes qytetarit dhe institucioneve të shtetit, ngritur mbi bazën e një kuptimi të drejtë të raportit mes të drejtave që qytetari gëzon në një demokraci, dhe detyrimeve që ai ka.

Është në fakt, çështja që u shtrua për zgjidhje që të nesërmen

e ndryshimit të regjimit në vitet '90, që detyrimi dhe kolektivizimi i imponuar i diktaturës të mos kishte si alternativë anarkinë, fragmentizimin social dhe abuzimin, por ndërgjegjësimin social, respektimin e shtetit dhe të ligjit, si një domosdoshmëri e jetesës së përbashkët. E cila, fatkeqësisht, me gjithë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur ndërkohë në shoqërinë shqiptare, ende s'ka gjetur një zgjidhje të kënaqshme.

Sigurisht, është shqetësuese kur sheh nivelin e mosbesimit të qytetarëve ndaj institucioneve më të rëndësishme të shtetit, por njëkohësisht, dhe një dëshmi të lartë pakënaqësie për thuajse gjithë institucionet që ofrojnë shërbime për qytetarin. Por ndoshta ka dhe një mënyrë tjetër se si mund të lexohen këto të dhëna. A mos ndoshta ato duhen parë si dëshmi e një maturimi relatin demokratik të shoqërisë, e cila tashmë kërkon më shumë? Nëse është vërtet kështu, kjo pakënaqësi mund të lexohet si një trysni e shëndetshme, të cilën klasa politike e së pari qeveria e institucionet kryesore të shtetit shqiptar, do duhej ta lexojnë si një kërkesë për të kryer një sërë reformash të thella me qëllim që të ndryshojë vetë mënyra e cilësia e funksionimit të institucioneve mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik.

Ky është një përfundim ku në një farë mënyre të çon dhe fakti se, ndërsa shqiptarët janë të pakënaqur me funksionalitetin e demokracisë në vend, pra me mënyrën se si funksionojnë institucionet e këtij sistemi, ata vazhdojnë ta konsiderojnë sistemin demokratik dhe ekonominë e tregut si të vetmen alternativë të mundshme për të ardhmen e tyre.

Këtë fakt e konfirmon dhe një vrojtim i kryer kohët e fundit në rrjetet sociale nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Tiranë. (15) Sipas tij, rezulton po ashtu se 70% e të anketuarave janë të pakënaqur me funksionalitetin e demokracisë në Shqipëri. Por ajo që paraqet më shumë interes është mënyra se si e interpreton ky Raport bashkëveprimin e këtyre dy të dhënave që, në vështirësi të parë, mund të duken disi kontradiktore me njëra tjetrën. Sipas raportit të PNUD-it, kjo tregon se *'Shqipëria është një vend që po kalon nga faza e vendosjes së demokracisë dhe ekonomisë së tregut, në fazën e konsolidimit të tyre. Shqipëria,' gjithnjë sipas të njëjtit Raport, 'e ka arritur atë që mund të konsiderohet si pika e pakthyeshmërisë (the point of irreversibility), por përballat me sfidën e madhe të funksionalitetit, që faktikisht identifikohet si një nga sfidat kryesore të sotme dhe të ardhme.'* (16)

Të njëjtin përfundim duket sikur e konfirmojnë dhe tregues të tjerë në po të njëjtin anketim, që lidhen me qëndrimin e qytetarëve për një sërë masash që ndërmori qeveria shqiptare në fund të vitit që shkoi, sic që ajo për pagimin e konsumit të energjisë elektrike, për prishjen e ndërtimeve pa leje etj. Interesante është që sipas këtij sondazhi on-line rezulton se pjesa dërmuese e qytetarëve shprehte mbështetjen për masat e ndërmarra, pavarësisht kostos që kjo mund të sillte. (17)

Nëse e marrim një përfundim të tillë si të mirëqenë, kjo do të thotë se janë gjithnjë e më të shumtë ata shqiptarë që, duke e parë veten në pasqyrën e Evropës së Bashkuar, shprehin pakënaqësinë e tyre me realitetin e gjërave në vend, çka nëse lexohet siç duhet, mund të përbëjë një faktor të rëndësishëm nxitës për reforma e

ndryshime. Një tregues i tillë do ishte me mjaft rëndësi në çastin kur për Shqipërinë më në fund do të hapen negociatat për anëtarësim, kur, siç tregon përvoja e vendeve të tjera ish-komuniste të Europës Qendrore e Lindore që e kanë përshkuar tashmë me sukses këtë rrugë para nesh, atë e presin reforma për të cilat nevojitet detyrimisht një konsensus sa më i gjerë kombëtar.

Në këtë kontekst, vlera e një studimi si ‘Drejt ripërcaktimit të kontratës sociale’ i cili, siç shprehen vetë autorët në hyrjen e studimit, *‘skicon panoramën e qëndrimeve të përgjithshme të qytetarëve shqiptarë ndaj shtetit, institucioneve, shërbimeve publike, ofrimit privat përkundrejt atij publik të shërbimeve, si dhe nënvizion qëndrimet kryesore të qytetarëve ndaj shtetit të mirëqënies sociale, solidaritetit shoqëror, etj,’* është pikërisht sepse sjell përmbledhtazi qëndrimin dhe pritshmërinë e qytetarëve për disa prej shtyllave kryesore mbi të cilat ngrihet Modeli Social European. (18). Fusha këto ku do nevojitet të kryen reforma të thella, të cilat për të qenë të sukseshme do duhet detyrimisht të *‘marrin në konsideratë nevojat, opinionet dhe pikëpamjet e qytetarëve’*

Siç u tha dhe në krye të këtij kapitulli, një leximi i gjetjeve të të tre studimeve të con në disa përfundime interesante përsa i takon nivelit të kulturës politike të qytetarëve shqiptarë, pra të nocioneve mbi të cilat ngrihen qëndrimet, pikëpamjet apo dhe pritshmëritë e tyre në raport me zhvillimet politike, ekonomike e sociale të vendit.

Në fakt, që të tre studimet tregojnë me një sërë shembujsh, se si në jo pak raste qëndrimet e pritshmëritë e qytetarëve mund të duken vertet disi kontradiktore, jo koherente, shprehin

koncepte hibride, të cilat mund të shpjegohen sa me ndikimin e së shkuarës komuniste, aq dhe me përvojën kontradiktore që ata kanë përjetur gjatë 25 vjetëve të tranzicionit pas-komunist shqiptar.

Kështu, për shembull, pjesa më e madhe e shqiptarëve (65 përqind e të anketuarve) duket është e mendimit se ekonomia e tregut është sistemi i duhur ekonomik për Shqipërinë, por po ashtu, po shumica e të anketuarve kërkojnë një ekonomi ku shteti të jetë i pranishëm në një masë të konsiderueshme. (19) Në fakt, 84 përqind e të anketuarve, pra një shumicë e qartë, shprehin mendimin se, 'shteti duhet të rregullojë marrëdhëniet ekonomike, rregullat e përgjithshme të konkurrencës dhe tregtisë, et.). Gjë që në fakt, do të thotë se më shumë se sa për një ekonomi të mirëfilltë tregu, shumica e qytetarëve shqiptarë duket se janë për një ekonomi mikste.

Në të njëjtën linjë duket se është dhe fakti se, pavarësisht nga pakënaqësia që ata shprehin për nivelin e cilësinë e shumicës së shërbimeve publike, pjesa më e madhe e të anketuarve duket se vazhdojnë të besojnë se shërbimet më me rëndësi për jetën e qytetarëit duhet të vazhdojnë të mbeten në duart e shtetit. (20)

S'ka dyshim se qëndrime të tilla, sidomos kërkesa për një prani të dukshme të shtetit në ekonomi, deri në një farë mase janë shprehje e ndikimit të mendësive të periudhës komuniste. Kjo mendësi duhet të shpjegojë, për shembull, përse rreth 2/3 e të anketuarve, kur pyeten mbi rolin e shtetit në ekonomi, janë të mendimit se shteti duhet të ndërhyjë aktivisht në ekonomi, madje duke përcaktuar

cmimet e mallrave, apo dhe duke mbrojtur bizneset strategjike. Vetëm 1/3 e të pyeturve mendojnë se shteti nuk e ka këtë rol në ekonominë e tregut. (21)

E njëjta gjë mund të thuhet deri diku dhe për mendimin që shpreh 77 për qind e të pyeturve, sipas të cilëve tregu s'duhet lenë të vendosë vetë për gjithçka, duke kërkuar rrjedhimisht një përfshirje dhe rol më të madh të shtetit.

Pra, në fakt, në vështrim të parë të krijohet përshtypja sikur në qëndrimet e qytetarëve ekziston një lloj keqkuptimi përse i takon rolit që mund dhe duhet të luajë shteti në ekonominë e tregut, aq sa madje, të duket sikur ata e presin që t'ua zgjidhë që gjithëcka shteti. Shembull i një qëndrimi të tillë kontradiktor, për shembull, është ai i qëndrimit që shfaqet kur është puna për privatizimin e shërbimeve: kur nga njëra anë qytetarët duket sikur mendojnë që shteti do duhet të vazhdojë të kryejë gjithë shërbimet bazë, vec me një cilësi më të mirë; kurse, nga ana tjetër, ata nuk nuk janë të gatshëm që të paguajnë më shumë taksa për të pasur këto shërbime. Në fakt, 51 përqind e të anketuarve iu përgjigj negativisht pyetjes nëse: 'niveli i taksave do duhet të rritet, nëse kjo do të sillte rritjen e cilësisë së shërbimeve'. (22)

Mund të vazhdohet gjatë me shembuj të tillë që dëshmojnë natyrën kontradiktore të mjaft prej koncepteve që përcaktojnë turbull vizionin e një pjese të qytetarëve shqiptarë për të ardhmen, por mendoj se sa u përmend më sipër mjafton.

Shkaqet e një dukurie të tillë janë të shumta, komplekse, por në

një farë mënyre dhe të kuptueshme. Ato lidhen padyshim me trashëgiminë e gjysmë shekulli të sundimit komunist, shembja e menjëhershme e të cilit la pas një vakuum legjitimiteti, që ushqeui atë klimë anarkie që fatkeqësisht karakterizoi një pjesë të mirë të tranzicionit shqiptar, që shpeshherë mori forma të dhunshme e shkatërrimtare dhe e çdo lloj autoriteti. Ndryshimi i sistemit nënkuptoi, siç dihet, një krizë dramatike të vetë jetesës së përbashkët, duke nxjerrë në pah veç mungesës shqetësuese të kohezionit të brendshëm social, edhe një krizë të rëndë të ndjenjës së shtetit. Për qytetarin shqiptar, ishte e vështirë të kuptonte se sistemi i ri s' nënkuptonte vetëm të drejta por edhe detyrime të shtetasve në një shoqëri demokratike.

Por do të ishte gabim të përpiqesh të shpjegosh kundërthëniet e shumta që vazhdojnë të karakterizojnë në shumë raste qëndrimet e qytetarit, thjesht me trashëgiminë e komunizmit. Ato lidhen, padyshim, edhe me një sërë mendësish e shprehish, që përbëjnë një problematikë me të cilën shteti shqiptar u ndesh që me krijimin e tij para një shekulli. Është fjala këtu, para së gjithash, për kulturën e trashëguar të mosbesimit ndaj shtetit, sidomos në pjesën rurale të vendit. (23)

Por, s'ka dyshim, se ndikim edhe më të madh në perceptimet dhe qëndrimet e shprehura nga qytetarët në anketime të tilla ka përvoja që ata kanë përjetuar gjatë 25 vjetëve tranzicion. Ndaj dhe kundërthënie si ato më sipër, ndoshta, më shumë se sa produkt i ndikimit të mendësive komuniste, duhen lexuar si një reagim i tyre ndaj zhgënjimeve të përjetuara gjatë kësaj periudhe, kur klasa politike shqiptare duke kontribuar me politikat e saj populiste për

deformimin e funksionimit të institucioneve të jetës së përbashkët, u tregua krejt e paaftë që të ndërmernte reformat e nevojshme dhe të hartojë politikat e duhura që do t'i shërbenin kthimit të besimit të qytetarit të shteti dhe institucionet e tij.

Nga ana tjetër, s'duhet harruar se pavarësisht ritmeve relativisht të kënaqshme të rritjes ekonomike, sidomos në dhjetë vjetarin e parë të viteve 2000, treguesit ekonomikë të Shqipërisë vazhdojnë të mbeten mjaft nën mesataren e Bashkimit Evropian. Kështu, për shembull, në vitin 2009, vlera e këtij treguesi për Shqipërinë mezi arrin në rreth 27% të mesatares së BE-së (24) Dhe vetë rajoni qendror i Shqipërisë që është më i zhvilluar krahasuar me pjesën tjetër të vendit, mezi arrin te rreth 35% e mesatares së BE-së. Nëse një analizë e tillë bëhet në nivel prefekturash, rezulton se, krahas dallimit mjaft të madh që ekziston mes Tiranës dhe prefekturave të tjera, edhe vetë Tirana nuk arrin as në nivelin e 45% të PBB për frymë të Bashkimit Evropian. Pra, është fakt që Shqipëria, në tërësinë e saj, por dhe qendrat kryesore të saj, përfshirë kryeqytetin, nuk kanë arritur ende as në nivelin mesatar të PBB për frymë të BE-së. (25)

Ky është padyshim që ndikon në pritshmërinë e qytetarëve shqiptarë, të cilët si kurrë ndonjëherë më parë i kanë sot mundësitë ta krahasojnë veten me qytetarët e vendeve të tjera europiane.

Por, pavarësisht gjithë kësaj, një fakt të bie menjëherë në sy kur lexon gjetjet e të tre studimeve të këtij projekti: qytetarët shqiptarë, pavarësisht qëndrimeve të tyre ndoshta disi kontradiktore për çështje të veçanta, në përgjithësi shërehen për një shtet social.

Kërkesa e tyre kryesore sot është për një ndryshim rrënjësor të politikave shtetërore, që sic dihet, deri më sot, në përgjithësi e kanë shpërfillur dimensionin social. Është domthënëse që rreth 72 përqind e të anketuarve, pra një shumicë e qartë e tyre, janë të bindur se një shoqëri e drejtë është ajo shoqëri në të cilën ekziston solidariteti për grupet më të dobëta të shoqërisë. Një vizion ky që duket ka ardhur koha që klasa politike shqiptare, e tunduar shpesh gjatë këtyre dy dekadave nga joshja e teorive të modës neo-liberale, apo pseudo –liberale, tash e tutje duhet ta mbajë parasysh.

5. Demokracia jo-funksionale dhe qytetari

Një nga të dhënat padyshim më interesante të sondazhit me temë ‘Drejt një ripërcaktimi të ri të kontratës sociale’, është ai që ka të bëjë me mendimin e shqiptarëve për nivelin e demokracisë në vend. Sipas tij, rezulton se **vetëm 36 përqind e shqiptarëve mendojnë se Shqipëria është një vend tërësisht demokratik, ose që ajo është ‘një vend më shumë demokratik sesa jo demokratik’**. Ndonëse, gjithnjë sipas sondazhit, kjo përqindje ka pasur një rritje relative (36 përqind në vitin 2014, nga 32 përqind që ishte kjo shifër në vitin 2013), ajo e tregon qartë se shumica e shqiptarëve s’janë të kënaqur me nivelin e demokracisë në vend. (Sipas të tjera burimeve, marrë në një shkallë nga 0 (aspak demokratik), në 10 (plotësisht demokratik), mesataria e perceptimit të demokracisë prej shqiptarëve është 4.2. (26)

Sigurisht, autorët e studimit kanë të drejtë kur na kujtojnë se një shifër e tillë s’përbën diçka të pazakontë në rastin e të ashtuajturave regjime hibride, që përgjithësisht karakterizuan periudhën e tranzicionit pas-komunist në vendet ish-komuniste të Evropës Lindore apo Qendrore. Madje, sipas tyre, nga një krahasim mes të dhënave të vitit 2014 me ato të një viti më parë, mund të përfundohet se ndoshta është e udhës të mendohet se ‘Shqipëria po del nga periudha e tranzicionit, apo dhe që periudha e tranzicionit të ketë përfunduar tashmë,por këto zhvillime duan më tepër kohë për t’u reflektuar në perceptimet qytetare.’ (27) Duke pasur parasysh dhe

diskutimet e shumta që ka për vetë përkufizimin e kohëzgjatjes së tranzicionit (28), mendoj se do të ishte e nxituar të nxirrej ndonjë konkluzion. Aq më tepër që gjetjet e sondazheve të kryer në kuadër të këtij projekti tregojnë qartë se qytetarët janë të mendimit se jo vetëm që ka probleme me mënyrën e funksionimit të sistemit demokratik, por probleme besueshmërie kanë së pari pikërisht ato institucione që përbëjnë vetë thelbin e sistemit.

Kështu, do të ishte vërtet shqetësuese nëse do merrnim si të mirëqëna gjetjet që na sjell sondazhi i kryer nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare për nivelin tepër të lartë të mosbesimit që ekziston pikërisht për disa prej shtyllave mbi të cilat mbahet një sistem demokratik: fjala është për gjykatat (e sistemi i drejtësisë në përgjithësi), Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Parlamenti, apo dhe partitë politike. Kur pyeten drejtëpërdrejtë, nëse sistemi i drejtësisë në Shqipëri jep drejtësi, 73 përqind e të anketuarve i përgjigjen me një jo. (29)

Madje, duke lexuar gjetjet e të tre studimeve, shoh se pjesa më e madhe e shqiptarëve janë të mendimit se pikërisht mungesa e një shteti ligjor përbën burimin që ushqen disa prej 'plagëve' kryesore prej të cilave tashmë prej vitesh vuan demokracia e brishtë shqiptare. Në fakt, një pëundim i tillë s'është se përbën ndonjë surprizë, ai vecse konfirmon një mendim të cilin tashmë e ndan pjesa më e madhe e opinionit publik shqiptar: Në stadin aktual të zhvillimit të demokracisë shqiptare, mungesa e shtetit ligjor është kthyer në sfidën më madhore me të cilën përballlet shoqëria. Një sfidë nga e cila varet në një masë a një tjetër, dhe vetë zgjidhja e mjaft prej problemeve të tjera që ka vendi. Mungesa e shtetit

ligjor përbën po ashtu, një ndër pengesat kryesore që vendi do duhet të kapërcejë në rrugën drejt përmbushjes së standardeve për integrimin evropian.

C'është e vërteta, hendeuku ndërmjet ligjit të shkruar dhe zbatimit të tij në praktikë, ka qenë një ndër kapitujt më problematikë të gjithë periudhës së tranzicionit post-komunist shqiptar dhe vazhdon të mbetet i tillë. Ajo që ndryshon tani krahasuar me një dekadë më parë, është që ndërsa sot Shqipëria s'ka më problem mungesën e institucioneve demokratike, apo të një kuadri ligjor bashkëkohor, apo procedurave demokratike, problemi tani qëndron te keqpërdorimi e ligjeve dhe institucioneve për përfitime vetjake apo politike, cka ndikon drejtëpërdrejt në mbarë mjedisin politik, ekonomik e social të vendit, me pasoja serioze për vetë funksionalitetin e sistemit demokratik, të ekonomisë së tregut e të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Është pikërisht kjo arsyeja përse qytetari vazhdon të jetë mosbesues dhe i pakënaqur me mënyrën se si funksionon demokracia në Shqipëri. Sfida bëhet edhe më e vështirë, pasi, fatkeqësisht duhet thënë se tashmë kultura e moszbatimit të ligjit ka zënë rrënjë në shoqërinë dhe mendësinë shqiptare.

S'është e rastit që pikërisht problemi i sundimit të ligjit është tashmë prej disa vitesh në krye të listës së kushteve që Bashkimi Evropian i vuri Shqipërisë për marrjen e statusit të vendit kandidat, e tashmë, për hapjen e negociatave.

Në të vertetë, duhet thënë se që prej vitit 2010, kushtet e vena prej Brukselit kanë ardhur duke u përqendruar gjithnjë e më shumë pikërisht te çështja e sundimit të ligjit. Në 24 qershor të vitit 2014,

vendimi i BE-së për t'i dhënë Shqipërisë statusin e vendit kandidat, pas më se pesë vjetësh pritjeje, u përligj kryesisht me atë që u konsiderua *‘sukseset e arritura në reformat e ndërmarra në fushën e sundimit të ligjit, sidomos reformat në sistemin e drejtësisë, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit’* (29) Siç dihet, një rol vendimtar për të bindur vendet ende skeptike të BE-së për të miratuar dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, e patën disa operacione të suksesshme që ndërmori qeveria shqiptare pikërisht në prag të marrjes së vendimit. Fjala është për operacionin e suksesshëm të ndërmarrë kundër kultivimit të drogës në Lazarat, fshat ky i kthyer prej vitesh në një emblema të paligjshmërisë e njëkohësisht, të dobësisë së shtetit; apo dhe operacioni tjetër, edhe më i vështirë, për ti dhënë fund situatës së mospagimit masiv të faturave të konsumit të energjisë elektrike, si dhe disa operacione të tjerë të ngjashëm, të cilët bënë të shpresohesh se më në fund, diçka që duke ndryshuar. Dhe duket se vërtet diçka është duke ndryshuar, së paku, në mendësinë e qytetarëve.

Domethënëse për këtë janë të dhënat që na sjell një sondazh i kryer gjatë muajit janar të vitit 2015 nga zyra e Kombeve të Bashkuara në Tiranë, i cili, ndër të tjera, kishte në qendër pikërisht qëndrimin e qytetarëve lidhur me masat e ndërmarra nga qeveria për *‘forcimin e ligjit’*. Sondazhi u krye on-line, me një sërë pyetjesh ku qytetarët pyeteshin në mënyrë specifike se ç’mendonin për veprimet e fundit të qeverisë për ndalimin e ndërtimeve pa leje, për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike, respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor, duke filluar nga respektimi i semaforit në zonat urbane, mospirjen e duhanit në mjediset publike, ndalimi i zhurmave në lokalet e natës etj. Bëhej fjalë pra, për probleme për

të cilat ligji ekzistonte prej vitesh, por që asnjëherë deri atëherë nuk kishin marrë zgjidhje për shkak të mungesës së vendosmërisë së institucioneve përgjegjëse, apo mungesës së vullnetit politik për të ndërmarrë masa në dukje jo popullore.

Ndryshe nga ç'mund të pritej, e sidomos ndryshe përshtypja që të krijonte një pjesë e medias, ku zërat më të zëshëm ishin pikërisht ata që në një mënyrë a një tjetër ndjeheshin të prekur nga këto masa, rezultatet e sondazhit të PNUD-it treguan se shumica dërmuese e të anketuarve qenë në mbështetje të këtyre masave. Kështu, rreth 71 për qind e tyre u shprehën *pro* masave të qeverisë për pagesën e energjisë elektrike. Rreth 76 për qind e tyre u shprehën po ashtu, *pro* masave kundër ndërtimeve pa leje. Kjo shifër që që ende më e lartë dhe mbërrinte në rreth 89%, kur qytetarët u pyetën për masat për zbatimin e kodit rrugor, apo për zbatimin e ligjit kundër pirjes së duhanit në mjediset publike, ku shifra e atyre që e mbështesnin operacionin e ndërmarrë mbërrinte në 91 %.(30)

Rezultatet e këtij sondazhi të kryer on-line, që për pasojë përfshin një grup moshë të kufizuar, në një farë mënyrë qenë dhe një konfirmim i rezultatit të zgjedhjeve të fundit administrative (të qershorit 2014), ku shumica qeverisëse arriti të kishte një fitore të qartë në pjesën më të madhe të vendit, duke mos u penalizuar kështu nga pasojat e veprimeve të tilla, që shumëkush mendonte se do të kishin një kosto në terma elektorale.

Sigurisht që sfida bëhet mjaft më komplekse dhe më e vështirë kur bëhet fjalë për dukuri të tilla sikurse lufta kundër korrupsionit, pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së ligjit, që në vështirimin e

qytetarit konsiderohet si një ndër problemet më madhore që ka sot vendi. Vështirësi që lidhet së pari me vetë përhapjen e madhe të dukurisë, por dhe me faktin se ekziston perceptimi se gjatë gjithë këtyre 25 vjetëve tranzicion, pavarësisht se flitet shumë, asnjëherë kjo dukuri s'është lufutra dot seriozisht..

Faktet janë të qarta. Keshtu, sipas raportit për nivelit e korrupsionit të Transparency International (31), në vitin 2014, Shqipëria renditej e 110 ndër 175 vende të përfshira në studim, me vlerë të këtij indeksi 33. Sipas po këtij raporti, në percpetimin e qytetarëve niveli më i lartë i korrupsionit që sidomos në drejtësi, polici si dhe në sistemin shëndetësor. (32)

Pandëshkueshmëria e korrupsionit duket qartë edhe nga njëë fakt i thjeshtë: gjatë gjithë periudhës 2009-2013, gjykatat kanë dhënë vendime vetëm për rreth 40% të rasteve të kallëzuara në prokurori për korrupsion. Po kështu, krahasuar me numrin e kallëzimeve në prokurori për korrupsion, gjykatat kanë dhënë dënime vetëm për 24% të rasteve. (33)

Shkaqet e një dukurie të tillë janë të shumta e komplekse, që mendojmë se s'është vendi të analizohen këtu. Këtu do mjaftohemi vetëm duke venë në dukje një prej këtyre faktorëve, që ka ndikuar e ushqyer korrupsionin, duke përbërë një prej deformimeve që vazhdojnë të shoqërojnë tranzicionin shqiptar, me ndikim në gjithë jetën institucionale të vendit. Është një dukuri që ka për aktorë partitë politike shqiptare, të cilave ky projekt i kushton një studim të vecantë, pikërisht sepse janë një prej aktorëve më me mjaft peshë të periudhës së tranzicionit dhe që mbajnë në një masë të madhe përgjegjisi

për deformimet prej të cilave vazhdon të vuajë sistemi demokratik shqiptarë. Deformime, që siç tregon ky studim dhe sondazhi që e shoqëron atë lidhur me demokracinë ë brendshme brenda partive politike, shpesh e kanë zanafillën pikërisht në mënyrën se si janë ngritur e funksionojnë partitë politike në Shqipëri. Është një studim krejt i veçantë në llojin e vet, që jep një kontribut të vyer që mund të ndihmojë për të korigjuar modelin e ndjekur deri më sot nga një prej aktorëve përcaktuespër zhvillimin e ardhshëm të vendit, si dhe për luftën me sukses kundër dukurive të tilla si ajo e korrupsionit.

Fjala është para së gjithash, për dukurinë e partitokracisë, një ndër deformimet më me pasoja të sistemit qeverisës shqiptar, ku prej vitesh tashmë në Shqipëri është krijuar një sistem ku partitë kanë prirjen ta njësijnë veten me shtetin, duke ndikuar në çdo vendimmarrje institucionale e publike.

Tipari kryesor i këtij sistemi mbetet kultura politike dominuese, sipas të cilës fituesi i merr të gjitha. Pasojë direkt e kësaj kulture para-demokratike është tendenca e kontrollit politik të institucioneve, dhe sidomos ngjyrimi politik i administratës publike pas çdo zgjedhjeje parlamentare.

Nga ana tjetër, pasojë e këtij mbi-pushteti të partive është kultivimi i traditës së zëvendësimit të institucioneve të forta funksionale me liderë të fortë politikë, personalizimi i politikës dhe institucioneve, ngushtimi i hapësirës dhe shanseve të publikut për të kontrolluar qeverisjen dhe për të mbrojtur interesat e tij, si dhe shtimi i hapësirave për zhvillimin e një shoqërie civile vibrante dhe një medie të pavarur. (34)

S'ka dyshim se dukuria e partitokracisë është një ndër faktorët që ka ushqyer mosbesimin e publikut për vetë mënyrën e funksionimit të institucioneve të pavarura, siç ka ndikuar dhe në mosfunksionimin e administratës publike. Kështu, nga gjetjet e sondazhit të kryer si pjesë e studimit 'Administrata publike në Shqipëri midis politikës dhe qytetarit' rezulton se, pavarësisht një sërë ndryshimesh pozitive të ndidhura vitet e fundit, sidomos për sa i takon nivelit të arsimimit dhe një kuadri ligjor më bashkohor, administrata publike shqiptare vazhdon të karakterizohet ende nga karriera të paqëndrueshme, probleme të lidhura me korrupsionin dhe ndikimet politike.

Nga një lexim i vërndshëm i gjetjeve të këtij studimi, s'është e vështirë të mbërrish në po të njëjtin përfundim që nxjerr dhe studimi në fjalë, kur thotë: 'Ndikimi i madh i politikës, gjerësisht i pranuar në administratën publike shqiptare duket se ka pasur kontribut mbizotërues në formësimin dhe ruajtjen e shumicës së problematikës të administratës publike në Shqipëri.' (36)

6. Fragmentizimi i shoqërisë dhe mungesa e kohezionit social

Siç u tha në krye të këtij studimi, në thelb të konceptit të ‘Modelit Social European’ qëndron pikërisht parimi se zhvillimi ekonomik s’duhet të shërbejë vetëm për të pasuruar një grusht të vogël njerëzish, por duhet të sigurojë një mirëqenie të përgjithshme të shoqërisë, duke shmangur kështu dallimet e tepruara sociale e ekonomike. Në Kartën Europiane të të Drejtave Themelore (The EU Charter of Fundamental Rights) (37), një ndër dokumentat bazë që konsakron Modelin Social European, përcaktohet qartë se parimet bazë mbi të cilët ngrihet Bashkimi European, çka nënkupton se secili prej shteteve anëtare ka për detyrë t’i verë ato në jetë që të garantojë kohezionin social, duke siguruar punësim, si dhe kushte dinjitoze jetese e pune për të gjithë, mbrojtje sociale për kë ka nevojë, si dhe duke luftuar varfërinë, marginalizimin dhe përjashtimin social.

I kujtuam të gjitha këto, pikërisht për të kujtuar se cilat janë ato standarde me të cilat Shqipërisë do t’i duhet të matet në çastin kur, më në fund, do të hapen negociatat e asociimit me Bashkimin European.

Por si është situata?

Vitet e fundit është folur shpesh me shqetësim, për pasojat që mund të sjellë në kohezionin social të shoqërisë shqiptare thellimi i pabarazisë, polarizimi ekonomik e social, e për rrjedhojë marginalizimi i grupeve të caktuara shoqërore, çka mund të çojë

një fragmentizim plot pasoja. Madje, ka zëra që shprehen se në fakt një fragmentizim i tillë, i prodhuar gjatë viteve të tranzicionit, është tashmë një realitet në shoqërinë shqiptare.

Përgjigja s'është dhe aq e thjeshtë. Megjithatë, s'mund të mohohet se shenjat e një fragmentimi shqetësues, pasojë së pari e varfërisë dhe e mungesës së politikave sociale të zhvillimit, padyshim që ekzistojnë. Por le t'i hedhim një vështrim këtij problemi nga më afër:

Duke lexuar gjetjet e studimit/sondazhit, 'Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale', kupton se **për qytetarin shqiptar është krejt e qartë se cilat janë ato probleme që kërkojnë sa më shpejt t'u jepet një zgjidhje: papunësia, varfëria, drejtësia dhe më në përgjithësi, sundimi i ligjit.** (38)

Për dy të parat mund të thuhet se tashmë ato janë kthyer në një problem kronik të tranzicionit shqiptar, që paradoksisht duket që s'ka një lidhje të drejtëpërdrejtë me nivelin e rritjes së ekonomisë. Një zhvillim pa punësim, e quan këtë dukuri një raport i kohëve të fundit.(39) Kështu, sipas të dhënave zyrtare, është e vërtetë që pas vitit 2008, rritja ekonomike ka pësuar një lloj rënieje. Kjo për shkak të një sërë faktorësh e politikash të brendshme, por sidomos për shkak të faktorëve të jashtëm që lidhen me efektet e krizës botërore në ekonominë shqiptare. E megjithatë, është po ashtu e vërtetë se brenda dekadës së fundit, prodhimi kombëtar thuajse është dyfishuar.(40) Një rritje ekonomike kjo që fatkeqësisht jo vetëm që s'është shoqëruar me të njëjtin nivel punësimi, por përkundrazi, sërish sipas të dhënave të INSTAT, gjatë së njëjtës periudhë niveli i punësimit ka njohur një rënie të ndjeshme, duke humbur mbi 220.000

vende pune.(41) Kërkesa për fuqi punëtore njohu një ulje sidomos pas rënies ekonomike të vitit 2008, çka natyrshëm solli një rënie të ndjeshme në të ardhurat familjare të jo pak shqiptarëve. Vetëm në vitet 2008- 2009, numri i të punësuarve ra me 123 mijë vetë.

Por ka dhe një fakt tjetër edhe më shqetësuese, që ka të bëjë me faktin që nga kjo rënie u prekën më shumë pikërisht ato dy grupe që përgjithësisht konsiderohen dhe më vulnebalilët: të rinjtë dhe gratë. Kështu, sipas të dhënave të Bankës Botërore, gjatë kësaj periudhe punësimi për të rinjtë ka pasur një rënie prej rreth 8 përqindsh, kurse për gratë rënia ka qenë rreth 5 përqind, shifër kjo që për grupmoshën e femrave 15-24 vjeç, arrin deri në 11 përqind. Rezulton se papunësia ndër të rinjtë është deri në dy herë më e lartë nga niveli i papunësisë në përgjithësi. (42)

Një problem tjetër që lidhet drejtëpërdrejtë me këtë situatë, është pabarazia e zhvillimit. Gjatë periudhës së tranzicionit Shqipëria ka njohur një rritje ekonomike, që e ka bërë atë të kalojë nga një vend me të ardhura të ulëta, në grupin e vendeve me të ardhura të mesme e të larta,(43) gjë që fatkeqësisht s'është shoqëruar kudo me të njëjtin nivel zhvillimi për të gjithë qytetarët dhe, aq më pak me një zhvillim njerëzor të qëndrueshëm. Përkundrazi, gjatë së njëjtës periudhë pabarazitë ekonomike dhe sociale janë thelluar dhe diversifikuar edhe më tej. Kështu, sipas të dhënave të INSTAT-it, janë rreth 14.3 përqind e shqiptarëve që në vitin 2012 konsideroheshin si të varfër, duke qenë se konsumonin më pak se 4891 lek në muaj për frymë, që përbën dhe linjën e varfërisë absolute të llogaritur për Shqipërinë. (44)

Problem, po ashtu, përbën dhe e ashtuquajtura ‘gjeografi e varfërisë’, ose diferencat e mëdha që ekzistojnë përsa i takon nivelit të zhvillimit midis rajoneve të ndryshme të vendit, cka lidhet jo vetëm me nivelin e varfërisë absolute, por dhe me një sërë treguesish të tjerë që lidhen me shërbime të tilla, si furnizimi me ujë, kushtet sanitare, niveli i arsimit, etj . Dallime domethënëse në këtë drejtim ekzistojnë sidomos mes qytetarëve dhe fshatarëve, të cilët në përgjithësi janë të privuar nga pjesa më e madhe e shërbimeve publike.

Gjithnjë sipas INSTAT-it, “pavarësisht se në përgjithësi, varfëria jo-monetare ka ardhur duke u zbutur, për shkak të investimeve të vazhdueshme në fushat përkatëse... rreth një individ në katër vazhdon të mos ketë ujë të rrjedhshëm brenda banesës ose edhe më keq, rreth 14 përqind e individëve janë fare pa ujë të rrjedhshëm. Po kështu, numri i individëve që ka akses në energji elektrike pa ndërprerje mbetet ende nën 70 përqind, me gjithë **përmirësimet e vazhdueshme dhe pakësimin e ndërprerjeve të energjisë.**” (45)

Sidoqoftë, pavarësisht nga të gjitha këto që thamë, duhet shtuar se, sipas Treguesit të Progresit Social 2015, ndër 133 vende të cilat përfaqësojnë rreth 94 përqind të popullësisë botërore, Shqipëria renditet në vendin e 52-të, duke u përfshirë në grupin e vendeve me progress social mesatar, me vlerë treguesi 68.19, duke lenë pas vende si Maqedonia, Turqia, apo Bosnje Herzegovina. (46)

Mungesa e një dimensionit social gjatë tranzicionit pas-komunist shqiptar, shfaqet edhe më qartë te një dukuri tjetër, që në fakt është krejtësisht në kundërtësim me parimet mbi të cilat është ngritur

vizioni i 'Modelit Social European'. Fjala është për polarizimin e skajshëm ekonomik e social.

Në shoqërinë shqiptare është shfaqur plot arrogancë një polarizim thuajse i skajshëm ekonomik, me implikime sociale lehtësisht të kuptueshme. Madje, të krijohet përshtypja sikur tranzicioni pas-komunist shqiptar ka shërbyer vetëm për të krijuar një grusht i vogël të pasurish, të cilët janë duke kontrolluar gjithnjë e më shumë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, të politikës e të jetës shqiptare. Në një vend të varfër si Shqipëria, kuptohet se pasurimi i skajshëm i këtij grupi tejet të kufizuar ka qenë i mundur vetëm në kurriz të pjesës tjetër të popullësisë.

Të dhënat faktike janë vërtet shqetësuese: Kështu sipas raportit të paraqitur në Parlament nga kreu i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave Bankare, rezulton se gjatë vitit 2014, vetëm *“4 përqind e qytetarëve shqiptarë zotëronin 60 përqind të kursimeve të depozituara nëpër banka”*. (47) Është pak a shumë e njëjta shifër me atë të raportuar dhe një vit më parë.

Ndërkohë, sipas “World Ultra Wealth Report 2012–2013”, rezulton se në Shqipëri, 55 individë kanë një pasuri e cila mbërrin deri në shumën e shtatë miliardë dollarëve, e cila është e barbartë me gjysmën Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit. Sipas këtij raporti, pasuria e miliardërëve shqiptarë u rrit me 4.1 përqind, pavarësisht recesionit në shumë vende të botës. Sipas këtij raporti, Shqipëria, përsa i takon individëve super të pasur, ia kalon vendeve të tjera të rajonit tonë si Maqedonisë, Bullgarisë apo dhe Malit të Zi.

Do mjaftonin këto të dhëna për të dalë në përfundimin se tranzicionit pas-komunist shqiptar i ka munguar së pari pikërisht dimensionin social, që siç pamë, përbën një prej kërkesave kryesore të Modelit Social European. Pasojat që kjo ka prodhuar në nivel shoqërie, besoj se s'është e vështirë të merren me mend.

Kjo situatë të lejon, sigurisht, të nxjerrësh disa konkluzione: Përfundimi i parë është se, pavarësisht se klasa politike shqiptare vazhdimisht ka shpallur si objektiv të saj madhor integrimin në Europën e Bashkuar, ajo ka shpërfillur tërësisht një ndër komponentët kryesorë mbi të cilët është ngritur ky Bashkim: pra pikërisht Modelin Social European dhe atë që ky nënkupton.

Por, ç'është më kryesorja, tregues të tillë në një shoqëri si ajo shqiptare, të dalë prej komunizimit si më e varfra dhe e prapambetura ndër gjithë vendet ish-komuniste të Europës, që për pasojë më shumë se çdokush kish nevojë 'për një sistem të mirëstrukturuar të mirëqënies sociale', si dhe për amortizatorë socialë, flasin për një deformim të vetë modelit të zhvillimit.

Edhe një masë e ndërmarrë nga ana e Partisë Socialiste pas ardhjes së saj në pushtet, në mes të vitit 2013, ajo e vendosjes së një sistemi taksimi progresiv mbi fitimin, mesa duket ende s'ka dhënë efektet e duhura. Mungesa e një shpërndarjeje të drejtë të të ardhurave në një shoqëri si ajo shqiptare, është pasojë e ambiguiteve që kanë karakterizuar dhe vazhdojnë të karakterizojnë gjithë sistemin demokratik në Shqipëri. Ato kanë prodhuar tensione, që në kushtet e vazhdimit të stanjacionit ekonomik, rrezikojnë të prodhojnë faktorë risku me natyrë sa sociale aq dhe ekonomike.

Ndonëse s'ka dyshim që Shqipëria ka shënuar një progres të pamohueshëm drejt marrëdhënieve të reja të shtetit me qytetarët, të cilat mbështeten në barazinë e tyre përpara ligjit, problemet që lidhen me vetë mosfunksionimin e shtetit ligjor, e bëjnë këtë problem edhe më shqetësuese. Sipas sondazhit të kryer nga Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, shumica e të anketuarve që e mendimit në Shqipëri ka njerëz që qëndrojnë mbi ligjin. (48)

Nga ana tjetër, dukuri të tilla si polarizimi social e ekonomik, varfëria, thellimi i pabarazisë, përjashtimi dhe marginalizimi social dhe ekonomik i grupeve, shtresave apo rajoneve të caktuar, lidhet drejtëpërdrejt dhe me disa prej 'plagëve të tjera' nga të cilat vuan tranzicioni shqiptar, si korrupsioni, krimi e tj.

7. A ekziston një kërkesë për një shoqëri më të drejtë dhe më solidare nga ana e shqiptarëve?

Përgjigja e kësaj pyetjeje mund të ndahet në dy pjesë: Nga njëra anë mjaftojnë disa të dhëna për të kuptuar se sa pak vëmendje i është kushtuar dhe, (pavarësisht disa ndryshime pozitive) vazhdon ti kushtohet në Shqipëri grupeve dhe shtresave më vulnerable e më në nevojë. Për ta ilustruar këtë do mjaftonte të silleshin disa të dhëna që kanë të bëjnë me dy grupe shoqërore që përgjithësisht konsiderohen si më vulnerabilët në çdo shoqëri. fëmijët dhe të moshuarit, për të kuptuar se sa larg është Shqipëria qoftë dhe nga standartet më minimale të cfarëdo modeli social.

Kështu, ndonëse në vitin 2010 u miratua një ligj i vecantë: ‘Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve’, si dhe aktet e tjera nënligjore që rjedhin prej tij, treguesit e mirëqënies së fëmijëve tregojnë se gjendja e tyre vazhdon të mbetet shqetësuese. (49) Shqipëria vazhdon të ketë nivelin më të lartë të vdekshmërisë foshnjore dhe të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjec në Ballkan. Sipas statistikave të fundit të Bankës Botërore në Shqipëri rezultojnë 13 vdekje për cdo 1000 lindje, një shifër kjo që është sa dyfishi i asaj të vendeve të tjera të rajonit (Bosnje Herzegovina 7, Serbia 6, Mali i Zi 5, Maqedonia 6). (50) Po kështu, vazhdojnë të ekzistojnë probleme shqetësuese përsa i takon pjesëmarrjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, ku gjatë periudhës së tranzicionin pati një rënie

drastike. Situata mbetet veçanërisht shqetësuese në zonat rurale, ku mund të thuhet se ky lloj shërbimi thuajse nuk ekziston.

Mjaft shqetësuese është po ashtu, mungesa thujase e plotë e vemendjes nga ana e shtetit për fëmijët që janë objekt i përjashtimit social, sic është rasti i të ashtuquajturve ‘fëmijë të rrugës’, i fëmijëvetë familjeve të ngujuara për shkak të gjakmarrjes, i fëmijëve të familjeve të varfëra, atyre që janë objekt i dhunës dhe i trafikimit, fëmijë pa kujdesin prindëror, fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe më në përgjithë, fëmijë të cilët jetojnë në zonat rurale.

Shumë shqetësuese është sidomos situata e fëmijëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian, të cilët pëjetojnë një situatë marginalizimi social pothuajse të plotë. Për të kuptuar pasojat e kësaj situate, mjaft të përmendim se, sipas të dhënave, rezulton se 4.6% e të gjithë fëmijëve të moshës 11-15 vjec, janë duhaanpirës të rregullt. (51)

Po kështu, sipas të njëjtit raport, rezulton se aktualisht në Shqipëri janë 93.000 të moshuar që jetojnë të vetmuar, në kushte mjaft të vështira ekonomike e sociale, thuajse pa asnjë lloj shërbimi social. Në Tiranë, një qytet me një popullësi prej rreth 800.000 banorësh, aktualisht ka vetëm pesë qendra ditore për këtë grupmoshë, dhe ato të pajisura keq. Po ashtu qendrat rezidenciale për të moshuarit janë fare të pakta dhe për më tepër, përgjithësisht s’arrijnë të përmbushin kërkesat e shumta që ato kanë. (52)

Një problem mjaft shqetësues, i cili do vinë duke u agravuar gjatë viteve të ardhshme, është ai i të moshuarëve, të cilët si rezultat i nivelit të lartë të informalitetit që ka ekzistuar në tregun e punës

gjatë gjithë dy dekadave të fundit, s'gëzojnë pension pleqërie. Kjo bën që ky grup, sidomos gratë, në periudhën e pleqërisë të njohin një rënie drastike të të ardhurave. Pozitiv është fakti që në fillim të vitit 2014, qeveria më në fund ndërmori reformën e pensioeneve, ku për herë të parë parashikohet pensioni social për moshat mbi 70 vjec, si dhe rritja e incentivave për sigurim drejt pensioneve të llojeve të tjera 53), gjë që pritet të ndikojë sado pak në përmirësimin e gjendjes.

Besoj se mjaftojnë këto të dhëna, të cilave sigurisht që mund t'u shtohen shumë të tjera për aspekte po aq të rëndësishme të jetës së përbashkët, për të kuptuar se aktualisht shoqëria shqiptare është duke u përballur me gjithë pasojat e deformimit të modelit, që bëri që në emër të shembjes së komunizmit e të gjithfarë pseudo-teorish neo-liberaliste, të vihej u në jetë një kapitalizëm i egër, pa shumë rregulla, ku s'kishte vend për thujtse asnjë lloj amortizatori social, apo për mekanizmat mbrojtës që zakonisht ngrihen kundër rrisqeve që sjell me vete ekonomia e tregut, sidomos kur bëhet fjalë për një shoqëri që përjeton gjithë ndryshimet rrënjësore që sjell me vete ndryshimi i sistemit.

Për thujtse njëzet e pesë vjet tranzicion në shoqërinë shqiptare kishte fare pak vend për solidaritet për më të dobët e më të varfrit. Kjo është sigurisht njëra anë e medaljes. Ana tjetër është ajo që rezulton nga të dhënat e studimit/sondazhitme autor Lleshaj dhe Cela, 'Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale', të cilat japin një panoramë disi të ndryshme.

Nga përgjigjet që japin qytetarët për pyetjet që lidhen me këtë problematikë, të krijohet bindja se në nivelin e shoqërisë diçka

është duke ndryshuar. Një numër gjithnjë e më i madh shqiptarësh janë duke u ndërgjegjësuar se më në fund, diçka duhet të ndryshojë dhe në këtë drejtim. Shumë prej përgjigjeve që ata japin, të cilat në vështrim të parë mund të duken disi kontradiktore, në fakt s'janë veçse shprehje e pakënaqësisë së tyre për gjendjen ekzistuese. Mesazhi që ata dërgojnë nëpërmjet këtij sondazhi, është se tashmë ka ardhur koha që në shoqërinë shqiptare të bëhet një korrigjim i rëndësishëm, i cili nis pikërisht nga kërkesa për një shoqëri më të drejtë, për një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave, për më shumë drejtësi sociale, më shumë solidaritet, mbrojtje sociale e shanse të barbara për të gjithë.

Kështu, për shembull, 72 përqind e të anketuarve, një shifër kjo mjaft e lartë, shfaq mendimin se 'shteti duhet të asistojë të dobët të shoqërisë, madje 36 përqind ndër ta janë të mendimit se 'askush nuk duhet të lihet pa shërbime publike, pavarësisht nga aftësia për të paguar apo jo'.

Në vijim, kemi një përqindje edhe më të lartë, e cila shkon deri në 83 përqind të të anketuarve, që mendojnë se shuma që marrin aktualisht familjet në formën e asistencës së papunësisë, është tepër e vogël. Siç venë me të drejtë në dukje autorët e studimit, një shifër kaq e lartë tregon se qytetarët e perjetojnë këtë nevojë pavarësisht nga përvoja e tyre personale. Në përgjithësi, mund të thuhet se nga gjithë përgjigjet që marrin pyetjet e kësaj natyre, shihet qartë se pritshëmritë e qytetarëve janë për një shtet më social, ku askush s'duhet të mbetet i përjashtuar apo i marginalizuar. Kështu një përqindje mjaft e lartë e të anketuarve mendon se shteti duhet të jetë përgjegjës për të ndihmuar njerëzit me aftësi të kufizuara; 89

përqindndër ta që mendojnë se shteti duhet të garnatojë kujdes të përshtatshëm shndetësor për të sëmurët; 84 përqind ata që janë në favor të asistencës financiare për familjet e varfëra; 78 përqind e të anketuarve kërkojnë 'mbrojtje dhe mundësi të vecanta për grupet e dobëta në shoqëri', e kështu me radhë. (54)

Është inkurajuese kur sheh se tashmë pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë janë të ndjeshëm kur bëhet fjalë për ato kategori sociale që ata i perceptojnë si më të rrezikuarat. Por edhe më rëndësi merr fakti që, me sa duket nga përgjigjet që qytetarët japin, ata tashmë janë ndërgjegjësuar se për të pasur një shtet të tillë social, nevojitet të ndryshojë vetë qasja e deritanishme përsa i takon zhvillimit ekonomik e social të shoqërisë shqiptare, duke korrigjuar vetë modelin e zhvillimit. Me këto kërkesa të tyre qytetarët shkojnë në kahun e duhur, drejt iu afruar atyre vlerave e parimeve mbi të cilat ngrihet modeli social që karakterizon modelin evropian.

Pse e them këtë?

Sepse s'ka si të interpretohet ndryshe fakti që 78 përqind e të pyeturve mendojnë se trashmë shteti duhet të ndërhyjë për të zvogëluar diferencën/hendekun që ekziston midis të pasurve dhe të varfërve, ndër të cilët 43 përqind kërkojnë nga shteti që të luajë një rol më aktiv në këtë drejtim. Janë pak ata që i përgjigjen kësaj pyetje, në mënyrë negative, pra që e konsiderojnë se 'hendeku mes të varfërve dhe të pasurve është një çështje ku shteti s'ka pse të ndërhyjë.' Dhe, sic sqarojnë autorët e studimit, ky është një grup që përbëhet kryesisht nga ata që kanë të ardhurat më të larta, dhe që rjedhimisht do të ndjeheshin të prekur nga politikat që do kishin për synim një rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave. (54)

Si përfundim, për të përmbledhur, le të themi se nga të dhënat e studimit të sipërpërmendur rezulton se **pjesa më e madhe e shqiptarëve mendojnë se sistemi i duhur për Shqipërinë është ai demokratik, ndërsa sistemi i duhur për ekonominë është ekonomia e tregut. Por nga ana tjetër, ata kërkojnë prej shtetit që të luajë një rol më aktiv nga c'ka luajtur deri më sot.** 57 përqind e të pyeturve dëshmojnë se janë të pakënaqur me nivelin e shërbimeve që shteti shqiptar i ofron qytetarëve. Por ata janë edhe më të pakënaqur me politikat e ndjekura deri më sot prej qeveritarëve shqiptarë, që paaftësinë e tyre për t'i siguruar qytetarit shërbimet e duhura publik, janë përpjekur ta mbulojnë nëpërmjet të ashtuquajturave privatizime, pra duke ia kaluar përgjegjësinë për shërbime të tilla si bazë, si arsimimi, apo kujdesi shëndetësor, te privati, ku shërbimi kryhet përkundrejt pagesës. Një akt ky që, vec të tjerash, vetëm sa e thellon edhe më tej pabarazinë ekzistuese të shoqërisë shqiptare.

Kjo ndoshta shpjegon dhe atë që mund të duket si një qëndrim kontradiktor nga ana e qytetarëve: ndonëse ata janë të pakënaqur me nivelin dhe cilësinë e sistemit shëndetësor publik, apo të arsimit publik (58), ata prapë kërkojnë që këto shërbime bazë të mbeten publike, pra ti kryejë shteti.

Janë plot 88 përqind e totalit të të anketuarve ata që mendojnë se shteti duhet të garantojë arsimin, kurse 85 përqind japin të njëjtën përgjigje kur bëhet fjalë për kujdesin shëndetësor. Përsa i takon arsimit, shumica e të anketuarve përgjigjen se ai “duhet të jetë publik dhe i financuar prej taksave publike”. Janë fare të paktë ata që mendojnë se arsimi mund dhe duhet të manazhohet prej privatëve.

Dhe mos harrojmë se kjo ndodh kur tashmë prej disa vitesh në vend ekziston dukuria tepër e përhapur e një numri pafund institucionesh arsimore private në të gjitha nivelet e arsimimit. Pak a shumë të njëjta janë dhe përgjigje përsa i takon sistemit shëndetësor.

Në fakt, ajo që mund të thuhet është se ndonëse në pamje të parë mund të duken kontradiktore, po ti shohësh me kujdes, në tërësinë e tyre përgjigjet e pjesës më të madhë të të anketuarve janë koherente.

Kështu, është plotësisht koherente me përgjigjet e mësipërme përsa i raporteve mes publikes dhe privates, fakti që 70 përqind e të anketuarve janë të mendimit se “Kush fiton më shumë duhet dhe të paguajë më shumë.”, cka lë të kuptohet qartazi se këta qytetarë janë në favour të taksimit progresiv. (57)

Mjaft domethënëse si dhe interesante janë dhe dy gjetje të tjera të të njëjtit sondazh, që lidhen po ashtu drejtëpërdrejtë me çështjen e taksimit progresiv: përgjigjet që tregojnë korrelacionin që ekziston mes përgjigjes së dhenë dhe nivelit të të ardhurave të të pyeturve, apo profilit e tyre ideologjik. (58)

Përfundime:

Ndonëse nga gjetjet e tre studimeve/sondazheve është e vështirë të hamendësosh se cili është niveli i informacionit të qytetarëve përsa i takon 'Modelit Social Evropian', ato na lejojnë të kuptojmë se sot pjesa më e madhe e qytetarëve dëshiron të jetojë në një shoqëri më të drejtë, e cila të garantojë një mirëqenie për të gjithë dhe kiu të ekzistojë më shumë solidaritet.

Do ishte më së paku e nxituar që qëndrime të tilla të lidheshin me trashëgiminë e mendësive të periudhës komuniste. Që nga shembja e sistemit komunist tashmë kanë kaluar njëzet e pesë vjet, një pjesë e madhe e shqiptarëve s'kanë asnjë kujtim, ose kanë vec një kujtim fare të zbehtë të asaj periudhe, ndaj dhe zor se mendësitë e asaj periudhe mund të kenë një ndikim aq të madh sa të përcaktojnë qëndrimet e njerëzve për problemet që ata kanë sot, e aq më pak në pritshmëritë e tyre.

Shpjegimi i këtyre qëndrimeve të qytetarëve shqiptarë në favor të një shteti shumë më social nga c'është sot, duhen parë si rezultat i zhgënjimit të tyre me kapitalizimin e egër që ata provuan gjatë 25 vjetëve të tranzicionit pas-komunist.

Por ajo që ka rëndësi është që, në mënyrë të vetëdijshme ose jo, qytetarët shqiptarë sot kërkojnë ndryshime që, në fakt, do ta afronin shoqërinë shqiptare me ato standarte që asaj i kërkohet të përmbushë në rrugën e europianizimit. Ky do të ishte një kontribut

i tyre i vyer për procesin e integritetit.

Mbetet të shpresojmë se klasa politike shqiptare do ta kuptojë sic duhet këtë mesazh që i dërgojnë asaj qytetarët, duke ndërmarrë reformat e duhura për një zhvillim sa më të shpejtë ekonomik dhe social të vendit, të mbështetur mbi vlerat e parimet mbi të cilët ngrihet shteti i mirëqenies (welfare state), që përbën tiparin dallues të familjes së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Për më tepër, të gjithë aktorët relevantë të shoqërisë shqiptare duhet të kuptojnë se përvoja ka treguar se kjo do të ishte rruga e vetme për të siguruar kohezionin social të vendit, e njëkohësisht, se politikat sociale përbëjnë mënyrën më të mirë për të ruajtur një demokraci të qëndrueshme.

8. Procesi i integrimit në Bashkimin Evropian dhe roli i tij në shndërrimet e ndodhura në shoqërinë shqiptare

Është fakt që, pavarësisht se janë ende të shumta problemet që mbeten për t'u zgjidhur, ndryshimet që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit kanë qenë tepër të mëdha. Gjatë këtij një çerek shekulli Shqipëria ka përshkuar një rrugë tepër të gjatë, që e ka afruar atë si kurrë ndonjëherë më parë me Bashkimin Evropian.

Tashmë vendi është anëtar i NATO-s, qytetarët tashmë kanë mundësinë të lëvizin lirisht në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës, duke përmbushur kështu një ndër ëndrrat kryesore të fillimit të atij rrugëtimi të etiketuar rëndom në gjuhën e përditshme si 'integrim'

Ç'është edhe më rëndësishme, në 24 qershor të vitit 2014, ministrat e jashtëm të 28 vendeve anëtare të BE-së morën vendimin për t'i dhënë asaj statusin e vendit kandidat. Shqipëria në këtë mënyrë iu bashkuar grupit të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor – Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë - në listën e pritjes për hapjen e negociatave të aksesit në BE.

S'ka dyshim se kjo datë shënon një çast historik për aspiratën e shqiptarëve për t'u bërë pjesë e familjes evropiane, duke qenë,

në të njëjtën kohë, një konfirmim i ndryshimeve të mëdha politike, ekonomike e sociale që kanë ndodhur në vend deri më sot. Shqipëria sot është krejt e ndryshme nga Shqipëria e viteve '90-t. Por kjo datë ka dhe një rëndësi tjetër: pavarësisht se s'ka ende një datë të saktë se kur mund të nisin negociatat, dhënia e statusit të vendit kandidat shërben për të mbajtur gjallë premtimin e integritit evropian, si një objektiv i besueshëm. Rëndësi ka që ideja e Evropës të vazhdojë të mbetet forca kryesore frymëzuese për zhvillimet në vend. Për njëzet e pesë vjet me radhë pas rënies së komunizmit, motivi i integritit ka qenë forca kryesore motivuese për ndryshime, katalizatori i vërtetë i reformave. Premtimi i antarsimit në Bashkimin Evropian ka qenë dhe vazhdon të jetë forca e vërtetë shtytëse e frymëzuese e ndryshimeve pozitive; vetë Bashkimi Evropian ka qenë një monitorues autoritar për të mos lejuar devijimet dhe deformimet në rrugë e demokratizimit dhe europianizimit, por njëkohësisht dhe një ndërmjetës shpesh vendimtarë për zgjidhjen e tensioneve apo krizave politike në vend.” Rëndësi ka që të vazhdojë të mbetet e tillë në Shqipëri, por dhe në rajon.

Në vitin tashmë të largët 1991, komunizimi ra në Shqipëri në thirrjet ‘E duam Shqipërinë si gjithë Europa! Sot, njëzet e pesë vjet më pas, pjesa dërrmuese e shqiptarëve vazhdon të jetë e bindur se e vetmja rrugë zhvillimi, modernizimi dhe garantimi e sigurisë të vendit, vazhdon të mbetet integriti i plotë në gjirin e familjes europiane.

Problemi s’është thjeshtë të kohëzgjatja e një faze të tillë të ndërmjetme mes marrjes së statusit të vendit kandidat dhe antarësimit të plotë në Bashkimin Evropian. Në fakt, vetë shqiptarët janë gjithnjë e më të ndërgjegjshëm se rruga deri në antarësimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian ka për të qenë e gjatë, dhe

se ajo do të kërkojë një sërë ndryshimesh të mëdha e të thella në vend, sidomos për sa i takon mënyrës së funksionimit të shtetit ligjor dhe të institucioneve, por po ashtu, persa i takon standardeve që duhet të përmbushë shoqëria për të venë në jetë atë që tashmë njihet si 'Modeli Social Evropian'.



Shënime

1. Instituti Studimeve Ndërkombëtare, Shqipëria dhe Integrimi European, Tirane, 2015
2. Për më shumë shih 'The Past and Future of the European Social Model', Christoph Hermann and Birgit Mahnkopf, Institute for International Political Economy Berlin, 2010.; László ANDOR, European Commissioner responsible for Employment, Social Affairs and Inclusion, 'Strengthening the European Social Model?', Conference "Progressive Paths to Growth and Social Cohesion. A Future Agenda for Eastern and Central Europe" - Vilnius, 11 November 2013
3. Për më shumë shih, European Union, EU Treaties, /www.Europa.eu
4. Për më shumë, shih Piro Misha, 'Cdo të thotë sot të jesh shqiptar, Tirane, 2009
5. idem, ff. 125-147
6. Burawoy, M & Verdery, K – Uncertain Transition, Yale University Press, 1999
7. Shqipëria u pranua si antare e NATO-s në prill të vitit 2009...
8. Shqipëria mori statusin e vendit kandidat për në BE në qershor të vitit 2014.
9. Afrim Krasniqin dhe Ardian Hackaj, 'Demokracia e Brendshme në Partitë Politike Shqiptare'
10. Sashenka Lleshaj dhe Alba Çelën, ka për temë 'Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale', faqe 82-84
11. idem, faqe 32

12. idem, f. 14
13. idem, ff. 15-16, ff.47-51
14. Për një shqyrtim të gjerë të problemit të partitokracisë, shih Afrim Krasniqin dhe Ardian Hackaj, 'Demokracia e Brendshme në Partitë Politike Shqiptare'
15. Për këtë, shih rezultatet e sondazhit botuar te Raporti Zhvillimit Njerëzor, PNUD, Tirane, 2015 , shih grafiket ff. 15-16, ff. 48-49
16. idem, ff. 5-8
17. idem. ff.17-18
18. Sashenka Lleshaj dhe Alba Çelën, vepra e cituar, ff. 17-18
19. idem, ff. 14, ff. 31-46
20. idem. Ff. 31-46
21. idem, po aty
22. idem, ff.18-19
23. për më shumë, shih Piro Misha, vepra e cituar
24. Shih RNUD _Raporti Zhvillimit Njerëzor 2014, Figura 3.6, f.
25. idem. Ff.13-14
26. Transformation Index BTI , 2014, Verlag Bertelsmann Stiftung, 2014
27. Lleshaj, Cela, po aty, ff. 13-14
28. Ardian Civici, Shqipëria, një tranzicion i vështirë. Nga planifikimi I centralizuar dhe kolektivizimi drejt ekonomisë së tregut, Tirane, 2013
29. Lleshaj, Cela, po aty, ff.15-16
30. European Commission (2014) *On Albania's Progress in the Fight Against Corruption and Organised Crime and in the Judicial Reform*.COM(2014) 331 final, p. 11
31. Raporti PNUD, idem, shih ff. 40-45, figura 2.10

32. Transperency International, Corruption Perception Index 2014, Tiranë, tetor 2014.
33. Grafiku është ndërtuar sipas të dhënave të dokumentit “Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
34. ACER dhe SELDI, Raport i vlerësimit të korrupsionit në Shqipëri, Tiranë, tetor 2014.
35. Për më tepër për këtë temë, shih Elona Dhembo, ‘Adiministrata Publike në Shqipëri midis Politikës dhe Qytetarit’, si dhe Afrim Krasniqin, Ardian Hackaj, ‘Demokracia e Brendshme në Partitë Politike Shqiptare’
36. Elona Dhembo, vepra e cituar.
37. idem, f. 47
38. EU Charter of Fundamental Rights - u bë e detyrueshme për vendet antare të Bashkimit European, me Traktatin e Lisbonës, në dhjetor të 2009. Në të përfshihen ato cka konsiderohen të drejtat themelore të qytetarëve të BE-së – E drejta e dinjitetit, e drejta e lirisë, e drejta e barazisë, solidariteti, të drejtat qytetare dhe drejtësia.
39. Lleshaj, Cela, po aty, ff. 82-83.
40. Raporti Zhvillimit Njerëzor 2014, idem, f. 54
41. Sipas të dhënave të INSTAT, Tiranë, 2014
42. INSTAT, Dinamika e Tregut të Punës 2001-2011, Tirane, maj 2014.
43. The world Bank Group, Albania – Systematic Country Diagnosis, Draft and Confidential, January 2015.
44. World Bank 2013 <http://data.worldbank.org/country/albania> Albania income level Upper middle income GDP level (current US\$ 12.90 billion 2013 Population, total 2.774 million, 2013. Të ardhurat për frymë të Shqipërisë janë

- 9.225 USD dhe nisur nga kjo vlerë ajo përfshihet në grupin e vendeve me zhvillim mesatar njerëzor (me të ardhura mbi 5.960 USD dhe nën 13.231 USd për frymë.
45. INSTAT, Anketa e matjes së Standarteve të Kushteve të jetesës LSMS 2012, Tirane, mars 2015
46. Idem.
47. Porter, M, Stern, S. Social Progress Index 2015, New York, March 2015
48. Ora news, lajmet e datës 22.04/2015
49. Lleshaj, Cela, po aty, f. 76. Po për këtë temë shih dhe, Arben Malaj, Vamir Gashi .Thellimi i pabarazisë, rreziku që po rritet', Panorama, 12 qershor 2015
50. Raporti Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë, PNUD, 2015, faqe 76.
51. <http://data.worldbank.org/indicator/SP.DYN.IMRT.IN>.
52. [http://www.observator.org.al/wp-content/uploads/2013/Varferia e fëmijëve ne Shqipëri- En2013.pdf](http://www.observator.org.al/wp-content/uploads/2013/Varferia_e_femijëve_ne_Shqipëri-En2013.pdf).
53. Raporti Zhvillimit....., ff. 78-79
54. Po aty
55. Lleshaj, Cela, po aty, ff.76-82
56. Idem, f.77
57. Idem, f. 48
58. Idem, f. 20
59. Idem, po aty